



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 361, Datë 07.12.2023

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “GEALB ENERGY” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E  
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET “GURI I  
BARDHË 1” DHE “GURI I BARDHË 2”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2 gërma “a”, 38, pika 1, gërma “a”, dhe 39, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1 gërma “a”, 13 dhe 14, pika 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2042/17 prot., datë 05.12.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Guri i bardhë 1 dhe “Guri i bardhë 2”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042 prot., datë 17.08.2023, paraqiti aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet total të instaluar 9300 kW. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 256, datë 23.08.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 24.08.2023 dhe 25.08.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 22.09.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresat me nr. 2042/3 prot., datë 30.08.2023 dhe me e-mailin me nr. 2042/5 prot., datë 19.09.2023, nr. 2042/8 prot., datë 13.10.2023, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe duke i kërkuar dokumentacionin e konstatuar të plotësuar pjesërisht.
- Shoqëria me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 2042/4 prot., datë 15.09.2023, nr. 2042/6 prot., datë 21.09.2023, nr. 2042/7 prot., datë 02.10.2023, nr. 2042/9 prot., datë 16.10.2023 ka depozituar dokumentacion plotësues nga i cili rezultonte ende i pa plotësuar vërtetimi që nuk ka detyrime ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- Meqenëse ky vërtetim është një dokument thelbësor për të vijuar me licencimin e shoqërisë, si i tillë bordi i ERE-s, me vendimin nr. 304, datë 23.10.2023 vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes mbi licencimin e shoqërisë “Gealb Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1” dhe “Guri i Bardhë 2”, dhe brenda 20 (njëzetë) ditëve shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k., duhet të depozitojë vërtetimin që ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj organeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- Me shkresën me nr. 2042/11 prot., datë 26.10.2023, ERE ka njoftuar shoqërinë mbi vendimmarrjen e bordit për zgjatjen e afatit dhe mbi dokumentacionin e mbetur ende pa plotësuar.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042/13 prot., datë 20.11.2023 ka depozituar dokumentacionin por nga shqyrtimi nuk rezultoi dokumentacioni i kërkuar, për këtë arsye ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën me nr. 2042/15 prot., datë 24.11.2023 të depozitojë dokumentacionin e kërkuar.
- Për sa mbetur pa plotësuar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2042/16 prot., datë 24.11.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin sipas përcaktimeve të nenit 9, pikës 1.1 gërmat “a”, “b” dhe “c”; pikës 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikës 1.3, gërmat, “a”, “b” dhe “c”; pikës 2.1, gërmat, “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- Shoqëria ka depozituar në ERE *Deklaratë Mjedisore*, e cila aktualisht është e vlefshme por duke qënë se shoqëria nuk ka filluar ende punimet, vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë të informojë ERE-n në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentraleve brenda datës 03.02.2024 i cili është dhe afati fundit i vlefshmërisë së VNM-së, në rast se nuk ka filluar ende punimet deri më datë 03.02.2024 duhet të depozitojë VNM e rinovuar brenda kësaj date.
- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data

e nënshkrimit të Kontratës së Koncesionit, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 6 vjet e 7 muaj nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 28 vjet e 5 muaj. Ndaj shoqëria vlerësohet të licencohet për afatin e mbetur.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të licencojë shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet “Guri i Bardhë 1”, “Guri i Bardhë 2”, në rrjedhën e përrenjve të Zallit të Dishit dhe të Shehut (degë e lumit Mat), Fshati Guri i Bardhë, Njësia Administrative Xibër, Bashkia Klos, Qarku Dibër, me kapacitet të instaluar 9300 kW, për një afat 28 vjet e 5 muaj.
2. Shoqëria “Gealb Energy” sh.p.k. të informojë ERE-n në lidhje me fillimin e punimeve të ndërtimit të hidrocentraleve brenda datës 03.02.2024, në rast se nuk ka filluar ende punimet atëherë të depozitohet VNM e rinovuar brenda kësaj date.
3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE në varësi të plotësimit të kushtit të lënë në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Gealb Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “Operatorin e Sistemit të Trasmetimit” (OST) sh.a., dhe “Furnizuesin e Tregut të Lirë” (FTL) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**